



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 108, Datë 23.03.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ATEANI ENERGY” SH.A., NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1 gërma “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 22/12 prot., datë 23.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 53, datë 20.02.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ATEANI ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 22.02.2023 dhe 23.02.2023), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 03.03.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresën nr. 22/7 prot., datë 23.02.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike

duhet të depozitohet në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 22/8 prot., datë 02.03.2023, dhe nr. 22/9, datë 03.03.2023, brenda afatit të sipërcituar, ka përcjellë dokumentacion plotësues për aplikimin e saj për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të Rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “ATEANI ENERGY” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të rregullores së licencimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ATEANI ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI